

V E N D I M
Nr. 285, datë 18.6.1999

PËR SHPËRNGULJEN E DOKUMENTEVE NË KOHË LUFTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 36, të ligjit nr. 7726, datë 29.6.1993 «Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat», me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpërnguljen e dokumenteve të çdo lloji, me rëndësi historike, kombëtare, të organeve qendrore të pushtetit të administratës shtetërore, të cilat dërgohen në vendruajtjen e Arkivit Qendror të Shtetit.

2. Shpërnguljen e dokumenteve të arkivave shtetërore të rretheve dhe të dokumenteve me rëndësi historike, kombëtare të organeve lokale të pushtetit e të administratës shtetërore, të cilat dërgohen në vendruajtjen e caktuar nga organi i prefekturës.

3. Shmangien, e të gjitha dokumenteve të tjera, që ruhen pranë organeve qendrore e lokale të pushtetit e të administratës shtetërore, që nuk shpërngulen, si dhe të dokumenteve, për të cilat bëhet fjalë në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, kur shpërngulja është e pamundur.

4. Asgjesimin e dokumenteve të çdo lloji, që kanë plotësuar afatin e ruajtjes, kur shmangia e tyre është e pamundur.

5. Transportimi i dokumenteve, që shpërngulen në kohë lufte prej organeve qendrore të pushtetit të administratës shtetërore, bëhet me automjetet e Ministrisë së Rendit Publik. Transportimi i dokumenteve të arkivave shtetërore të rretheve të organeve lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore bëhet me automjetet që organet e pushtetit lokal vënë në dispozicion të organeve të rendit publik.

Ruajtja e dokumenteve gjatë shpërnguljes kryhet nga organet e rendit publik.

6. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, SHIK-u dhe Ministria e Punëve të Jashtme të përcaktojnë masat për shpërnguljen dhe shmangien e dokumenteve të tyre, në përputhje me këtë vendim.

7. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Ministria e Rendit Publik, të cilat nxjerrin udhëzime sipas detyrave përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

8. Vendimi i Kryesisë së Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 7.2.1990 «Për shpërnguljen e dokumenteve arkivore», shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko